



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

VENDIM I TRUPIT GJYKUES

“Për korrigjimin e gabimit material në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të dhënë për subjektin e rivlerësimit z. Ardian Dvorani në datë 25.07.2018”

Sot në datë 05.10.2018, ora 13.00 trupi gjykues i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Elteda Çiftja	Anëtare
Firdes Shuli	Relatore

bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative: “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

- Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij,*

u mblodh për t’u njohur me kërkesën e relatores së çështjes Firdes Shuli për korrigjimin e një gabimi material në numrin e vendimit të dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Z. Ardian Dvorani.

Pas verifikimit në regjistrin e numërimit të vendimeve, u konstatua se në faqen 1, të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të dhënë për subjektin e rivlerësimit z. Ardian Dvorani, dhënë në datën 25.07.2018, numri i aktit është shënuar gabimisht “49” dhe numri i vendimit është shënuar gabimisht “51”. Ndërkohë, numri i saktë i aktit është “51” dhe numri i saktë i vendimit është “49”.

Sa më sipër, duhet bërë korrigjimi dhe saktësimi në faqen 1 të vendimit, si vijon : Numri i aktit “49” të korrigjohet duke u vendosur numri i saktë “51” dhe numri i vendimit “51” të korrigjohet duke u vendosur numri i saktë “49”.

Trupi gjykues, pasi konstatoi se pasaktësia është e dukshme dhe si pasojë e një gabimi material gjatë shtypjes së vendimit në faqen e parë, vleresoi se kërkesa e relatores është e bazuar.

Për këto arsye

Trupi gjykues bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative

V E N D O S I:

1. Në faqen 1, të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të dhënë për subjektin e rivlerësimit z. Ardian Dvorani të datës 25.07.2018, të bëhet korrigjimi i numrit të aktit duke e shkruar “51” dhe korrigjimi i numrit të vendimit duke e shkruar “49”.
2. Ky vendim përpilohet në 5 (pesë) kopje, nga të cilat një kopje i komunikohet subjektit të rivlerësimit, një kopje Komisionerit Publik, një kopje Vëzhguesit Ndërkombëtar, një kopje i bashkëlidhet vendimit të qepur në dosjen e subjektit dhe një kopje i bashkëlidhet vendimit të arkivuar pranë zyrës së arkivës së KPK-së.
3. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Trupi Gjykues

Roland Ilia

Elteda Çiftja

Firdes Shuli

Kryesues

Anëtare

Relatore

Sekretare gjyqësore

Anisa Duka

